

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Futën Ziza Pajazitin në burg/ Polici merret i pandehur, punonjësi: Më urdhëroi shefi i policisë
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/futen-ziza-pajazitin-ne-burg-polici-merret-i-pandehur-punonjesi-me-ur-i103231
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 12:48:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 12:43:33 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5c4c0e5f1f79212d3512d52b7ee397e92ee4b27fed6b54f4b47ea85e040726a3
TEKSTI	e9fb693bfa50922d4f4bd457d17127b1bc81eda1fe50c95e7535f6d052a250cb
PAMJA	f5d7f5f668bcc856bd071ed40a7a7b08632a2d548197ad09f28595ab9994ef78

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5b2a3c19ee8162ca5da4c6b2b22c0426c831edbf6162f9e1cb61ec938e3e7949
E MËPARSHMJA	a4f49d5fcdc4118edaca3d963432d243e6f0e82f5526f77d7a0b34c47d9040d9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5b2a3c19ee8162ca5da4c6b2b22c0426c831edbf6162f9e1cb61ec938e3e7949>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **ngriten kundër regjimit** | **vjetorit të Kryengritjes së Postribës, denonci i** | **itet si i zgjedhur nga neveria në të** | **publikimi të përgjimeve nga ish** | **merret i pandehur, punonjësi- burgun e** | **refugjatëve** | **deportimin e më shumë se një milion** | **godet efektivët** | **martë...**

AKTUALITET

Futën Ziza Pajazitin në burg/ Polici merret i pandehur, punonjësi: Më urdhëroi shefi i policisë

Nga Elton Qyno Përditësimi i fundit 9 Shtator 2026, 14:43



Futën Ziza Pajazitin në burg/ Polici merret i pandehur,

Perent Lëngu, një punonjës me karrierë 18 vjeçare në burgun e Drenovës të Korçës, është marrë i pandehur nga prokuroria për akuzën e “Falsifikimit të dokumenteve”, lidhur me rastin e skandalit të hyrjes dy herë në takim të modele Kosovare, Ziza Pajaziti.

Lëngu, rrezikon një dënim nga 1 deri në 7 vjet burgim, pasi hetimi ka zbuluar se ai në mënyrë të qëllimtë, ka falsifikuar dokumentin e takimit special në 13 qershor 2025 mes të dënuarit me burg përjetë Laert Haxhiu dhe Ziza Pajaziti.

Fakti që Perent Lënga, ka shënuar në dokument emrin e të dënuarit “Vladimir Kurti”, ndërkohë që takimin në realitet Ziza Pajaziti, e ka bërë me të dënuarin Laert Haxhiu, ka çuar në ngritjen e akuzës së “Falsifikimit të dokumenteve” për punonjësin e vjetër të burgut të Drenovës.

Gazetari Elton Qyno ka mësuar se lidhur me këtë skandal është marrë i pandehur dhe ish-shefi i policisë së Burgut të Drenovës, Sokol Kaçolli, ndaj të cilit prokuroria ngriti akuzën e “Deklarimit të remë para Oficerit të Policisë Gjyqësore.

Por për shkak se kjo vepër penale u amnistia nga Ligji për “Amnistinë”, ndjekja penale ndaj ish-zyrtarit të burgut të Drenovës, Sokol Kaçolli, është pushuar.

Ish-shefi i policisë së Burgut Drenovë, Kaçolli ka pasur dijeni të plotë mbi dy takimet e zhvilluara nga Laert Haxhiu dhe Ziza Pajaziti, por është munduar të heqë përgjegjësinë e tij nga kjo situatë.

Sipas dosjes hetimore në datën 12 qershor 2025, modelja Kosovare Ziza Pajaziti, është paraqitur në ambientet e burgut të Drenovës, ku ka kërkuar takim me të dënuarit me burg përjetë, Laert Haxhiu.

Me vete Ziza Pajaziti, kishte sjellë një parfum, disa paketa me puro të holla, 5 puro të trasha dhe një presë.

Pasi janë kontrolluar nga gardianët e burgut, ata kanë vënë në dijeni shefin e Policisë, Sokol Kaçolli, i cili erdhi së bashku me shefin e Regjimit të Brendshëm, Arshim Olldash.

“...ky i fundit provoi një nga purot dhe u tha policëve se ishin në rregull, duke na thënë të pyesnim drejtorin e burgut. Më pas u njoftua Drejtori, Fatjon Fasho, të cilit iu bënë me dije sendet në fjalë, dhe ai u përgjigj se, nëse ishin kontrolluar nga shefat dhe ishin në rregull, mund të lejoheshin të kalonin. Kështu vepruam...”-ka deklaruar njëri nga policët.

Ndërkohë Ziza Pajaziti ka vijuar me kontrollin në dhomën intime dhe pasi mori sendet që do ja çonte Laert Haxhiut, është future në regjim për takim.

Pajaziti, ka mbaruar takimin e datës 12 qershor me Laert Haxhiun dhe sërisht në 13 qershor 2025, është paraqitur në ambientet e burgut të Drenovës, duke kërkuar takim me të dënuarin Vladimir Kurti, pasi sipas saj këtë të dënuar e kishte të afërm.

Ziza, nuk kishte sjellë asgjë për Vladimir Kurtin. Por ka hyrë në regjimin e brendshëm të Burgut të Drenovës, duke zhvilluar takim jo me Vladimirin por me Laert Haxhiun.

Lidhur me këtë skandal është marrë në pyetje dhe i dënuari Vladimir Kurti, i cili ka pohuar se:

“...modelen kosovare Ziza Pajaziti, nuk e njoh dhe nuk kam realizuar asnjë takim me këtë shtetase. Gjithashtu, nuk kam kërkuar takim me të. Deklaroj se kam rreth katër muaj që nuk zhvilloj takime familjare...”.

Ndërkohë nga këqyrja e librave të shërbimit rezulton se, në datën 13 qershor 2025, Ziza Pajaziti është regjistruar për të takuar të dënuarin Vladimir Kurti, por në të vërtetë ka realizuar takim me të dënuarin Laert Haxhiu në një ambient pa kamera sigurie.

Punonjësi i Policisë së Burgjeve, Perent Lëngu, ka pasqyruar në librin e takimeve të dhëna të treme, sikur i dënuari Vladimir Kurti ka zhvilluar takim me Ziza Pajazitin. Gjithashtu, Perent Lëngu deklaroi se urdhërin për lejin e këtij takimi e ka marrë nga shefi i Policisë së burgut, Sokol Kaçolli.

Nga këqyrja e librave të shërbimit të IEVP Korçë rezulton se të dhënat e pasqyruara për takimin e datës 13 qershor 2025 nuk përputhen me pamjet filmike që monitorojnë këto ambiente.

Nisur nga deklarimi i shefit të Policisë, Sokol Kaçolli, i cili deklaroi se nuk ka dijeni për takimin e datës 13 qershor 2025, ndërmjet të dënuarit Laert Haxhiu dhe Ziza Pajaziti, si dhe se gjatë orarit kur ky i dënuar ka zhvilluar takim nuk ka marrë asnjë njoftim nga përgjegjësi i takimeve, Perent Lëngu, dhe se në atë orar ka qenë në zyrën e tij.

Nga këqyrja e pamjeve filmike rezulton se, në datat 12 qershor 2025 dhe 13 qershor 2025, është zhvilluar takim ndërmjet Zize Pajaziti dhe të dënuarit Laert Haxhiu në një ambient që nuk monitorohet nga kamerat e sigurisë.

Gjithashtu, në datën 13 qershor 2025, pas përfundimit të takimit ndërmjet Zize Pajaziti dhe të dënuarit Laert Haxhiu, rreth orës 15:04, në hyrje të ambienteve të takimeve, nga pamjet filmike konstatohet prania e shefit të Policisë, Sokol Kaçolli, i cili përshëndetë me të dënuarin Laert Haxhiu dhe shtetasen Zize Pajaziti dhe më pas largohet nga Regjimi i Brendshëm.

Nisur nga deklarimi i drejtorit të institucionit, Fatjon Fasho, rezultoi se ai ka mësuar se ky takim është lejuar nga shefi i Policisë, Sokol Kaçolli, pasi në datën 13 qershor 2025, ky i fundit ka takuar të dënuarin Laert Haxhiu, para zhvillimit të takimit dhe më pas ka shkruar tek përgjegjësi i takimeve, Perent Lëngu, së bashku me përgjegjësin e grupit të sigurisë, Kosta Xite.

Fatjon Fasho, ka pohuar se në cilësinë e drejtorit të institucionit, ka thirrur të gjithë zinxhirin e punonjësve për analizë, por vetëm shefi i Policisë, Sokol Kaçolli, nuk është paraqitur, duke shmangur pjesëmarrjen.

Nga këqyrja e librit të hyrje-daljeve të personelit në kolonën, Godina A, Sektori 1, ku është i akomoduar i dënuari Laert Haxhiu, rezultoi se shefi i Policisë, Sokol Kaçolli, ka hyrë në datën 13 qershor 2025 në orën 10:45 dhe ka dalë në orën 10:55.

Nga informacioni i ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mbi inspektimin e kryer në IEVP Korçë, rezultoi se janë konstatuar shkelje të rënda të elementeve të sigurisë në këtë institucion, duke lejuar që i dënuari Laert Haxhiu, i cili ndiqet me plan masash të veçanta për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqet, të zhvillojë takim me shtetasen Zize Pajaziti në ambiente të pamonitoruara nga kamerat e sigurisë, duke krijuar dyshimin e arsyeshëm se mund të jetë zhvilluar një takim special, pra marrëdhënie seksuale./SyriTv

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 9 Shtator14:30

[I riu tenton të arratiset në komisariatin e Sarandës, godet efektivët](#)

Një incident ka ndodhur ambientet e Komisarariatit të Policisë së Sarandës rreth orës 01:30 të së martë...

AKTUALITET 9 Shtator14:26

[“Qeveria shqiptare jeni ju”/ Ahmetaj nxjerr të tjera biseda të Ron Yeffetit: Procesi duhet bërë në mënyrë të heshtur](#)

Ish numri dy i qeverisë, Arben Ahmetaj, në një intervistë për News 24, ka zbardhur biseda të tjera mes biznesmenit Ron Yefet dhe...

AKTUALITET 9 Shtator14:15

[Vritet 35-vjeçari shqiptar në Itali, gjendet i lidhur në një makinë të fundosur në ujë. Dyshimet e policisë](#)

Një 35-vjeçar shqiptar është vrarë në Itali dhe trupi i tij është gjetur brenda një automjeti të fundosur në...

AKTUALITET 9 Shtator14:02

[Skenë krimi/ Sako përlan 15 milionë euro pa garë për mirëmbajtjen e rrugëve të lindjes me 99.99% të fondit limit](#)

Tenderi 50 milionë euro për mirëmbajtjen e rrugëve të vendit në katër vitet e ardhshme po shndërrohet mirëfilltaz...

AKTUALITET 9 Shtator13:57

[Euro në rënie edhe për shtatorin, pranë thyerjes së kufirit të 92 lekëve](#)

Kursi i këmbimit të Euros po vijon rënien edhe në dhjetëditëshin e parë të muajit shtator. Sipas kursit zyrtar të...

AKTUALITET 9 Shtator13:47

[Shpërthim pranë hidrocentralit Ritom në Zvicër/ Raportohet për disa të lënduar](#)

Një shpërthim është regjistruar paraditen e kësaj të mërkure pranë hidrocentralit Ritom, në zonën e Piotta-s...

AKTUALITET 9 Shtator13:34

[Pjesë e grupit të Visit të Pojës, ekstradohet drejt Italisë Ervis Deti](#)

Ervis Deti, i akuzuar si pjesë e grupit të drejtuar nga Ervis Doçi, i njohur si “Visi i Pojës”...

AKTUALITET 9 Shtator13:22

[Rinis zjarri në Çërrilë të Mallakastrës, flakët përhapen në sipërfaqe të gjerë të pyllit](#)

Ka rinisur mëngjesin e sotëm zjarri në Çërrilë të Mallakastrës, pasi vatra e zjarrit, e cila u shfaq pasditen e djesh...

AKTUALITET 9 Shtator13:17

[Zjarr në Bago të Kavajës, disa vatra aktive](#)

Një zjarr i përmasave të mëdha ka përfshirë që në orët e para të ditës zonën e Bagos në...

AKTUALITET 9 Shtator13:11

[SPAK nis verifikimet për denoncimet e Ahmetaj për trafik armësh. Sekuestrohen 6 përgjimet dhe emisioni i plotë](#)

Prokuroria e posaçme SPAK, ka vendosur të nisë verifikimet lidhur me deklaratat e forta të bëra nga ish-zv/kryeministri i Shqipëri...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 8 Shtator

[Bosi i drogës në kërkim nga SPAK filmoi në hote...](#)

Një figurë e krimit të organizuar, në kërkim nga SPAK për trafik droge, pastrim parash dhe organizatë kriminale, i njohur pë...

AKTUALITET 8 Shtator

[EMRAT/ U qëlluan me armë zjarri, kush janë dy t...](#)

Dy persona janë plagosur me armë zjarri mbrëmjen e sotme në zonën e Laprakës në Tiranë. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur ...

BOTA 8 Shtator

[I burgosur për vrasjen e gjashtë pacientëve, ek...](#)

Luca Spada, ish-shoferi i një ambulance, i cili aktualisht ndodhet në burg nën akuzën për vrasjen e gjashtë pacientëve, dysho...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënie të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtun “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënuar për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën“Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.